

## Krijohet Platforma Digjitale e Veprave Shqiptare



Veprat e autorëve të letërsisë shqiptare vijnë për herë të parë në formatin digjital falas për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen. Nisur nga mungesa e shumë veprave të digjitalizuara, Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës në kuadër të projektit "Diaspora për Zhvillim" sjell Platformën Digjitale të Veprave Shqiptare. Platforma është krijuar me qëllim gjallërimin dhe promovimin e kujtesës kolektive kulturore të komunitetit të Diasporës shqiptare si dhe krijimin e kushteve dhe nxitjen e angazhimit kulturor të anëtarëve të Diasporës shqiptare. Pjesë e platformës "Digjitalizimi i Veprave Shqiptare" do të jenë 100 vepra të një game të gjerë zhanresh nga autorë të Rilindjes Kombëtare, të letërsisë bashkëkohore shqiptare si dhe vepra të letërsisë për fëmijë. Digjitalizimi të veprave shqiptare i kushtohet një rëndësi e veçantë në Strategjinë Kombëtare për Diasporën, si një instrument për përcjelljen dhe ruajtjen e trashëgimisë gjuhësore e kulturore shqipe në Diasporë.

## Vota e Diasporës Shqiptare



Të interesuarit për të drejtën e votes në migracion, mund të gjejnë propozimet që i janë dërguar Komisionit të Reformës Zgjedhore [këtu](#).

## Mblidhet grupi ndërinstytucional i punës për rishikimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës dhe të Planit të Veprimit



U zhvillua mbledhja e dytë e grupit ndërinstytucional të punës për rishikimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës dhe të Planit të Veprimit, krijuar me Urdhrin Nr. 53, datë 9.4.2020 "Për ngritjen e grupit ndërinstytucional të punës për rishikimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës dhe të Planit të Veprimit". Gjatë takimit virtual, ministri Majko prezantoi draftin e Strategjisë dhe kërkoi sugjerimet e anëtarëve të grupit lidhur me rishikimin e masave të Planit të Veprimit. Strategjia e rishikuar do të paraqitet për miratim në fund të muajit qershor 2020. Grupi kryesohet nga ministri i Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko dhe në përbërje ka zëvendësministrat në ministrinë përgjegjëse për punët e jashtme, arsimin, financat, turizmin, punët e brendshme, drejtësinë, shëndetësinë, bujqësinë, kulturën; përfaqësues të ministrisë së Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes dhe Akademisë së Shkencave; dhe titullari i INSTAT-it dhe Agjencisë Kombëtare të Diasporës.

## Aplikacioni gazeta "Diaspora Shqiptare"



App store [këtu](#): Play store [këtu](#):

## Qendra e Botimeve për Diasporën, takim dypalësh me Atasheun e Arsimit të Ambasadës Turke



Drejtoresha e Qendrës së Botimeve për Diasporën, znj. Mimoza Hysa zhvilloi sot një takim me z. Atakan Doğan, Atasheun e Arsimit të Ambasadës së Republikës së Turqisë në Shqipëri lidhur me realizimin e projektit në bashkëpunim të fjalorëve dygjuhësh për fëmijë, shqip-turqisht. Pala turke ka marrë përsipër botimin, shtypjen dhe shpërndarjen e 50 mijë kopjeve të fjalorit të përgatitur nga Qendra e Botimeve për Diasporën, të cilat do të jenë gati për vitin shkollor 2020-2021, për nxënësit e gjuhës shqipe në Turqi. Mësimi i gjuhës shqipe në Turqi është pjesë e programit shkollor si gjuhë fakultative dhe ndiqet prej një numri të konsiderueshëm nxënësish. Ministria e Arsimit ka hartuar dhe shpërndarë për nxënësit e gjuhës shqipe tekste shkollore në tri nivele të hartuara nga Universiteti i Trakisë atje. Në takim u diskutua mundësia e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të përvojave me Universitetin e Trakisë si një nga universitetet më të mira dhe të rëndësishme turke.

## "Raporto" problemin në çdo kohë në Ambasadalme



App store [këtu](#): Play store [këtu](#):

## Drejtoresha ekzekutive e QSPA-së takim me përfaqësuesit e Raiffeisen Bank

Drejtoresha ekzekutive e Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët, znj. Diana Kastrati priti në një takim znj. Greta Lekaj, drejtore të Marrëdhënies me Publikun dhe CSR në Raiffeisen Bank si dhe Ministrin e Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko. Gjatë bashkëbisedimit, znj. Kastrati falenderoi znj. Lekaj, të cilët në kuadër të programit Raiffeisen Invest bënë të mundur pajisjen me kompjutera për të gjithë stafin e kësaj qendre kërkimore, e krijuar për herë të parë në historinë e shtetit shqiptar si një institucion me fokus të veçantë kryerjen e studimeve për komunitetin arbëreshë. Gjithashtu, znj. Lekaj u njoh edhe me disa nga objektivat dhe projektet kryesore për vitin 2020 si dhe studimet kryesore mbi të cilat është përqendruar puna kërkimore-shkencore e stafit të këtij institucioni.



## KKD / Bordi i shkollës shqipe "foleja e shqiponjave" zhvilloi mbledhje online

Në përgjigje të kufizimeve lidhur me pandeminë COVID-19, shoqatat dhe anëtarët e Diasporës shqiptare po vijnë me veprimtaritë e tyre përmes platformave online. Bordi i shkollës "Foleja e Shqiponjave", kryesuar nga Prof. Dr. Adriana Fishta Bejko me nën-kryetare Zoica Dhama dhe anëtarët Vjollca Ndokaj Guri, Shqipe Kuqi, Ermira Kusari, Kaltrina Kusari, Danjela Lumani Bregasi dhe Gëzim Ugzmaili diskutoi çështje të ndryshme lidhur me mbarrëvajtjen e mësimin të gjuhës shqipe për fëmijët shqiptarë në Calgary, Kanada. Nëpërmjet një njoftimi bëhet e ditur një hapësirë të veçantë mësimdhënies online si një formë e cila mund të kombinohet me pjesëmarrjen fizike në shkollë sipas kushteve të mundësuar nga shkolla "North Point". U propozua që meqenëse mësimi online është konsideruar i frutshëm gjatë kësaj periudhe, "Foleja e Shqiponjave" të konsiderojë mundësinë e kombinimit të orëve mësimore, "Foleja e Shqiponjave" do të pajiset me një mini-bibliotekë me libra letrarë në gjuhën shqipe të cilët do të sigurohen nga Qendra e Botimeve të Diasporës. Kjo "bibliotekë" do të shoqërohet me versione digjitale të librave jashtëshkollore që mund të ndiqen online. Shkolla "Foleja e Shqiponjave" i përket të gjithë komunitetit dhe, si e tillë, i jep mundësi të gjitha atyre që kanë arsimimin përkatës dhe dëshirën për t'u mësuar fëmijëve gjuhën tonë amtare të aplikojnë për mësues të gjuhës shqipe.

